

Gjatë raportimit para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Mbrojtjeje të FSK-së, komandanti i FSK-së Kadri Kastrati ka theksuar se fama në të cilën gjendet ndërtimi i shtetit të Kosovës, duke kaluar gjitha fazën tranzicionale të mbrojtjes ndërkombëtare, është kohë kur po punohet seriozisht që vendit të ketë joje edhe një forcë të re ushtarake që do t'i plotësonte nevojat e vendit për mbrojtje. "FSK-ja nuk transformohet më, ajo do të evoluohet në ushtri. Kjo që është tash vetëm do të plotësohet dhe do të bëhen disa ndryshime brenda strukturës dhe do të shndërrohet në ushtri", tha Kastrati në Komisionin Parlamentar. Ai shtoi se zhvillimi i një force të pajisur me teknikë dhe armatim bashkëkohor si në planin e mbrojtjes së kufijve në shtetit, edhe angazhimi e saj jashtë vendit në operatione paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit, është një parakusht i domosdoshëm që Kosova pa vonesë të shndërrohet në shtet eksportues i sigurisë, e jo se deri më tani vetëm si konsumues. "Është një grup punues, i cili është duke punuar në bashkëpunim me AKI-në, me Policinë e Kosovës dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë tjera për të parë në kontestin strategjik se çfarë rrezikesh i kanosen në të ardhmen nga jashtë dhe nga brenda shtetit të Kosovës. Në kuadër të këtij studimi do të hapet rruga e grupit punues për strukturë, mision dhe detyra të ushtrisë së Kosovës. Ne do ta propozojmë një forcë ushtarake, e cila do të jetë e gatshme që t'i përmbushë detyrat në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të shtetit dhe mision të dytë që do ta ketë pjesëmarrjen në operationet paqeruajtëse e humanitare jashtë Kosovës", tha Kastrati.

Disa në pension, të tjerë rekrutohen

Kastrati bëri të ditur se gjatë këtij viti, janë rekrutuar 35 pjesëtarë në komponentin rezervë, ndërsa, sipas

KOMANDANTI I FSK-së RAPORTOI NË KOMISIONIN PARLAMENTAR

Bëhen gati për ushtrinë



planit të ragnutimit për pjesëtarë të rezervës aktive, përmes konkursit të hapur, do të pranohen edhe 235 pjesëtarë të tiri. "Me Ligjin për pensionim të pjesëtarëve të FSK-së, që është në fuqi, do t'i pensionoimë 53 pjesëtarët, të cilët i kanë plotësuar kriteret për pensionim, sipas ligjit", tha Kastrati. Sa u përket trajnimeve dhe shkollimit e pjesëtarëve të FSK-së jashtë vendit, kuadro këto që do të jenë logjistika kryesore e ndërtimit të kapaciteteve të ushtrisë së re të

Kosovës sipas standardeve të NATO-s. Kastrati theksoi se në SHBA janë duke u përgatitur 15 pjesëtarë, në Gjermani 108 pjesëtarë, Turqi 4 pjesëtarë, Britani të Madhe 1 pjesëtar, ndërsa të martën është dërguar edhe një grup i kadetëve në kampin veror në Maqedoni, 10 kadetë, 1 oficer dhe 1 nënofficer, që do të kenë trajnime meritore. Ai ka folur edhe për illojet e armatimit me të cilin aktualisht është e pajisur FSK-ja. Kastrati tha se sa i përket armatimit,

FSK-ja është e pajisur me dy illoje të armësh të gjata dhe një illoj të armëve të brezit: pushkë "HK" me 1275 copë; pushkë "Kolt" me 530 copë dhe revole "Glock" me 486 copë. Megjithatë, ai deklaroi se ky armatim nuk është i mjaftueshëm për të gjithë ushtarët e FSK-së, por një armatim i plotë i gjithë efektivës mbase do të realizohet deri kah fundi i këtij viti, në mënyrë që secili ushtar ta ketë ngarkesë në përgjegjësi armën e vet personale. "Shtepndarja e armatimit akoma gjendet nëpër depo dhe nuk është shtepndarë vetëm për një arsye, akoma nuk e kemi për secilin ushtar armën, po i shtepndajmë këto që i kemi prapë do të na lëvizë arma prej një dore në një dorë tjetër dhe do të dëmtohen. Kuptohet që një numër janë dëmtuar, sepse ato dëmtohen kur një njeri nuk e ka të ngarkuar një armë të veten. Ne presim që pas kontingjentit të ardhshëm, që posa të vijë, të gjithë pjesëtarët e FSK-së i ngarkojmë individualisht me armën e vet dhe unë pres që pas ardhjes së kontingjentit t'i shtepndajmë nëpër kazerma, që secili individ, sipas tabelës organizative të pajisjeve që kemi, të ngarkohet me pushkën e vet dhe të jetë secili përgjegjës për armën e vet. Ne besojmë që kjo do të ndodhë gjatë këtij viti dhe ne do t'i shtepndajmë armët individualisht, për secilin ushtar", tha Kastrati në raportimin e djeshëm.

U shpenzuan rreth 9 milionë euro

Sa i përket buxhetit, Kastrati tha se vitin 2012 është 35.801.832 euro, përderisa në pesë muajorin e parë shpenzimet janë 8.917.96 euro, apo

Personeli ushtarak

Komandanti i FSK-së Kastrati, bëri të ditur edhe numrin e personelit ushtarak të MFSK/FSK-së, që ka gjithsej 2386 ushtarakë, në mesin e tyre 2194 janë meshkuj, 192 femra, ndërsa 191 janë minoritarë. Prej 2386 ushtarakëve, prej tyre oficerë të pasistemuar janë 5, kadetë në QSU 40, dhe OR1 të pasistemuar 73.

25 %. Si shumë pozitiv Kastrati e vlerësoi bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar të FSK-së. "Forcimi i bashkëpunimit, partneritetit dhe fuqizimit të raporteve me NATO-n, ekipet e NATO-s dhe me KFOR-in, ka qenë dhe mbetet prioritet i rëndësishëm i FSK-së. Gjatë kësaj periudhe KSK-ja ka arritur marrëveshje të rëndësishme së veçantë për bashkëpunim dhe partneritet me Gardën Kombëtare të Ajovent dhe ka filluar zbatim praktikë të kësaj marrëveshjeje", tha ai. Gjithashtu bëri të ditur se janë nënshkruar 8 memorandume të bashkëpunimit me Britani të Madhe, Lituani, Holandë, Turqinë, Shqipërinë, Maqedoninë, malin e Zi dhe me Kroacinë, ndërkaq, vazhdon harmonizimi i qëndrimeve lidhur me nënshkrimin e memorandumeve me Slloveninë, Gjermaninë dhe Lituanië.

S. AHMETI

Automjetet e amortizuara

Sa i përket kontingjentit të automjeteve në disponim, Kastrati tha se automjetet ekzistuese në FSK janë të ardhura nga furnizues të ndryshëm. "Një pjesë e tyre vijnë nga periudha e TMK-së, disa të tjera kanë ardhur nga donacionet e ndryshme dhe një pjesë është blerë nga buxheti i Qeverisë së

Kosovës, gjithashtu edhe nga "TRUST FONDI". Gjendja e pajisjeve ekzistuese nuk mund të konsiderohet e mirë, por arsye se një pjesë e madhe e tyre janë të vjetra dhe të amortizuara dhe kërkojnë mjete të shumta për mirëmbajtje dhe riparim", tha komandant Kastrati.